



Nr. 02/ZDP/VE/2016

Datë: 15 shkurt 2016

Në mbështetje të nenit 14.1, 14.2, 15.1 (f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, 4 qershor 2008), dhe nenit 13.1 të Rregullores së AAC-së nr. 3/2015 mbi tarifat e aeroportit, datë 8 qershor 2015,

Duke vendosur sipas propozimit të operatorit të aeroportit, LKIA ANP "Adem Jashari" ("operatori i aeroportit"), nr. 2016/ZDP/07, datë 4 shkurt 2015, për aprovim të Programit Nxitës 2016-2018,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës nxjerr këtë:

VENDIM

1. Aprovohet Programi Nxitës për ANP "Adem Jashari" 2016-2018 sipas propozimit të operatorit të aeroportit, nr. ref. 2016/ZDP/07, dt. 4 shkurt 2016, në përputhje me këtë vendim dhe për periudhën 27 mars 2016 deri më 24 mars 2018.
2. Miratimi i pikës 5.5, nxitja për operim në orare që janë më pak të ngarkuara, e përfshirë në Programin Nxitës nga pika 1 e këtij Vendimi, është jashtë kompetencave të AAC-së.
3. Nxitja e ofruar nën 5.1 duhet të jetë në dispozicion për të gjitha kompanitë të cilat plotësojnë kushtet dhe nuk mund të kufizohet vetëm në kompaninë e parë ajrore që fillon operimin e një destinacioni të ri nga ANP "Adem Jashari".
4. Çdo ndryshim i programit nxitës duhet të bëhet në pajtim me Rregulloren nr. 3/2015 mbi tarifat e aeroportit.
5. Obligohet operatori i aeroportit që t'ua ofrojë programin nxitës të gjitha kompanive ajrore që operojnë në ANP "Adem Jashari", në mënyrë jo-diskriminuese dhe ta publikojë këtë program në mënyrë të përshtatshme, si dhe të informojë AAC-në mbi zbatimin e këtij programi dhe ndonjë ndryshim eventual të tij.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Operatori i aeroportit ka dorëzuar versionin e parë të Programit Nxitës (*Incentive Program*) 2016-2018 për marrjen e aprovimit nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ("AAC") më dt. 25 janar 2015 si dhe versionin final të tij më dt. 4 shkurt 2016.

Në programin nxitës, pika 1 deri 5, thuhet se ai ka për qëllim rritjen e trafikut në këtë aeroport përmes nxitjes për zhvillimin e destinacioneve të reja, nxitjes për zhvillimin e frekuencave të reja, nxitjes për kompanitë ajrore që rrisin vëllimin ekzistues të trafikut, nxitjes për kompanitë që e stacionojnë së paku një aeroplan në Prishtinë, nxitjes për operimet në orare që janë më pak të ngarkuara (*off-peak*) dhe përmes mbështetjes për aktivitete marketingu kompanive ajrore që hapin destinacione apo frekuenca të reja në ANP "Adem Jashari".

Me qëllim të marrjes së aprovimit të AAC-së për programin e tij nxitës, operatori i aeroportit ka dorëzuar këto dokumente për shqyrtim:

- Programin Nxitës të operatorit të aeroportit ANP "Adem Jashari", dt. 25 janar 2015;
- Ftesën e datës 14 janar 2016 që u është bërë kompanive ajrore për të marrë pjesë në mbledhjen e Komitetit Konsultues të Shfrytëzuesve të Aeroportit ("Komiteti Konsultues") të datës 18 janar 2016;
- Procesverbalin e mbledhjes së Komitetit Konsultues të mbajtur më 18 janar 2016;
- Listën e pjesëmarrësve në mbledhje të Komitetit Konsultues;
- Komunikimin elektronik të datës 6 janar 2016 të nisur nga operatori i aeroportit dërguar zyrave qendrore të kompanive ajrore që operojnë apo që mund të operojnë në Prishtinë, së bashku me programin e propozuar nxitës për shqyrtim;
- Përgjigjet përmes emailit nga kompanitë: Adria Airways, Germanwings, Jetair, easyJet dhe SAS, të dërguara në periudhën kohore 14-18 janar 2016;
- Versionin final të Programit Nxitës 2016-2018 të operatorit të aeroportit ANP "Adem Jashari", dt. 4 shkurt 2016, në të cilin janë reflektuar disa nga komentet paraprake të AAC-së dhe kompanive ajrore që kanë marrë pjesë në konsultimin publik.

Në bazë të detyrave dhe përgjegjësiive të AAC-së sipas nenit 15(f) të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil si dhe nenit 13.1 të Rregullores nr. 3/2015 për tarifën e aeroportit, AAC-ja ka bërë shqyrtimin e këtyre dokumenteve dhe

KA KONSTATUAR SE:

- Programi nxitës i propozuar është një iniciativë transparente dhe inkurajim i mirë për kompanitë ajrore që të fillojnë destinacione/frekuenca të reja ose që të rrisin vëllimin e trafikut në ANP "Adem Jashari". Zbatimi i këtyre nxitjeve do të jetë i dobishëm për publikun duke iu ofruar mundësi më të madhe zgjedhjeje për të udhëtuar nga dhe për në ANP "Adem Jashari".
- Kushtet për dhënien e secilës prej pesë nxitjeve të ofruara në Programin Nxitës të propozuar nga operatori i aeroportit janë relevante, objektive dhe transparente. Megjithatë, sa u përket kushteve të listuara për dhënien e nxitjes 5.1, ka munguar qartësia rreth përfituesve potencialë të kësaj nxitjeje, prandaj AAC-ja ka vendosur si në pikën 3 të dispozitivit të këtij Vendimi.

- Programi nxitës u ofrohet të gjitha kompanive ajrore, pa asnjë përjashtim, të cilat bartin udhëtarë; të cilat operojnë ose planifikojnë të operojnë nga ANP "Adem Jashari"; dhe të cilat plotësojnë të gjitha kushtet e parapara në Programin Nxitës.
- Programi Nxitës është i kufizuar në kohë dhe është efektiv prej dt. 27 mars 2016 deri më 24 mars 2018.
- Operatori i aeroportit ka marrë parasysh disa nga komentet e kompanive ajrore gjatë hartimit të versionit final të Programit Nxitës të dt. 4 shkurt 2016.

Duke marrë parasysh se programi nxitës i operatorit të aeroportit ANP "Adem Jashari" ka për qëllim promovimin e hapjes së destinacioneve të reja dhe rritjes së numrit të fluturimeve, është i kufizuar në kohë (vlen për dy vite) dhe është proporcional me arritjen e objektivit të synuar, mund të përfundohet se, si i tillë, ky program është në interes të përgjithshëm dhe publik dhe se është në përputhje me kërkesat e nenit 13.1 të Rregullores nr. 3/2015 për tarifën e aeroportit.

Përjashtimisht, miratimi i pikës 5.5 të Programit Nxitës nuk është në kompetencë të AAC-së sipas Rregullores nr. 3/2015. Kjo nxitje implikon tarifën për shërbime në tokë që nuk janë tarifa të rregulluara aeronautike të listuara në nenin 4 të Rregullores nr. 3/2015 të AAC-së. Është në diskrecionin e operatorit të aeroportit të ofrojë nxitje për shërbimet në tokë, në pajtim me Rregulloren nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë. Sidoqoftë, nxitja për kompanitë ajrore sipas pikës 5.5 të Programit Nxitës të referuar më lart, duhet t'u ofrohet në mënyrë jodiskriminuese të gjitha kompanive që i plotësojnë kushtet e përcaktuara nga operatori i aeroportit.

Përmes korrespondencës elektronike të datës 12 shkurt 2016 në lidhje me kërkesën e AAC-së për të marrë vërejtjet që mund të ketë Partneri Publik rreth Programit Nxitës të propozuar nga Operatori i Aeroportit, Departamenti qendror për Partneritet Publiko Privat i Ministrisë së Financave ka këshilluar AAC-në të vazhdojë ushtrimin e përgjegjësive të AAC-së brenda kompetencave të parapara me Ligjin për Aviacionin Civil dhe aktet nënligjore përkatëse si dhe Kontratës së PPP në ANP.

Prandaj, në bazë të këtyre fakteve, mund të konkludohet se Programi Nxitës i operatorit të aeroportit është në përputhje me kërkesat e nenit 13.1 të Rregullores nr. 3/2015 për tarifën e aeroportit.

Duke u mbështetur mbi këtë bazë ligjore, Drejtori i përgjithshëm ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 15 shkurt 2016



Dritan Gjonbalaj
Drejtor i përgjithshëm

Udhëzim mbi mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të kërkohet rishikim administrativ pranë Komisionit të Ankesave të AAC-së, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Iu dërgohet:

Operatorit të ANP "Adem Jashari"

Departamentit Qendror PPP, Ministria e Financave

Departamentit të Aviacionit Civil, Ministria e Infrastrukturës